



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.12.2023, duke filluar në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Trierë Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB), Fehmi Kupina (i pavarur) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK) dhe Sami Boroci (AKR).

Të pranishëm ishin edhe Donjeta Sahatçiu, nënkyetare e Komunës, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Lulëzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi Osman Bllaca, i cili tha se, në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, sipas Ligjit përvetëzversije lokale, personi më i moshuar i pranishëm nga anëtarët e Kuvendit duhet ta udhëheqë seancën.

U konstatua se mbledhjen e Kuvendit do ta udhëheqë Nora Kelmendi.

Faqe 1 nga 4

Nora Kelmendi, kryesuese e mbledhjes, tha se në bazë të kërkesës së grupit të asamblistëve është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme me këtë

Rend dite:

1. Faljen e tatimit për pronën e paluajtshme për vitin tatumor 2023.

Gëzim Sveçla, para anëtarëve të Kuvendit e paraqiti propozimin e e asamblistëve të Kuvendit në lidhje me faljen e tatimit në pronë për pronën e paluajtshme për vitin tatumor 2023. Lidhur me këtë, ceku se ky propozim është zyrtar. Sipas Ligjit për tatimin në pronë, është krijuar një mundësi që komunat të vendosin për faljen e shumës deri në 100 euro për taksapaguesit e vetë.

Leutrim Retkoceri theksoi se Partia Demokratike e Kosovës e ka të qartë pse gjendet në këtë sallë, pra ne përfaqësojmë interesin publik të qytetarëve dhe do të votojmë për interesin publik të tyre. Ne sot do të ushtrojmë kompetencën tonë, për të aplikuar zbritjen e rritjes së vlerës së tatimit në pronë për banesat dhe shtëpitë e qytetarëve të kryeqytetit, pas një beteje të gjatë për 1 vit, nga ky Kuvend kur ne të parët kemi kundërshtuar raportin e ri të vlerësimit të pronave, që ka quar në rritjen enorme të çmimit të tatimit në pronë. Ne sot kërkojmë që të hiqet barra e rritjes së tatimit në pronë për qytetarët, vetëm qytetarët mund ta falin ose jo pushtetin që rrit tatime, ndërsa proklamimi për falje, e që është mashtrim. Ne do të jemi të gatshëm të bëjmë debate në interes të qytetarëve të kryeqytetit, mirëpo propozimet të cilat nuk kanë pajtueshmëri dhe nuk kanë për qëllim mbrojtjen e interesit publik, ne si PDK nuk do të miratojmë, por do të jemi të gatshëm të bëjmë propozime në mbrojtje të qytetarëve nga rritja e vlerës enorme të tatimit.

Endrit Gashi tha se ne si GP i AAK-së, e përkrahim këtë propozimvendim për faljen e 100€ për tatimin në pronë, pasi që shihet se ky propozim është një ndihmesë për qytetarët e Prishtinës.

Gëzim Mehmeti u shpreh se ne si asamblistë jemi betuar se do t'i mbrojmë interesat e qytetarëve pa dallim partiak, do të thotë se kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve dhe kjo nuk është çështje e interesit partiak. Pra qytetarëve në këtë krizë globale ekonomike t'ju falim 100 euro, është punë shumë e madhe. Kjo tregon demokraci, tregon se jemi me vullnetin e qytetarëve dhe kërkesat e tyre. Andaj, kërkoj nga të gjithë që t'i lëmë interesat partiake, të punojmë, mendojmë dhe të veprojmë sipas interesave të qytetarëve.

Endrit Zabërgja tha se duke pasur parasysh situatën socio-ekonomike të qytetarëve, shohim se është një domosdoshmëri e jona si asambleistë të marrim sot përgjegjësi karshi këtij problemi. Besoj se në situatën të cilën jemi, përtej petkut partiak duhet ta shohim interesin qytetarë dhe të mos mbësim prapa kësaj seance, por të jemi të suksesshëm në zgjidhjen e kompromisit. Andaj, i ftoj të gjithë kolegët asambleistë që mos ta shkaktojmë

Faqe2nga4

edhe një dëmë tjetër në kurriz të qytetarëve, të ulemi ta gjejmë një zgjidhje, një modalitet, të votojmë njëzëri për mbrojtjen e interesave të qytetarit.

Feim Osmani theksoi se të gjithë së bashku duhet ta analizojmë këtë propozim, ta shfrytëzojmë votën tonë dhe të vendosim ashtu siç e parasheh ligji.

Nuk po vërejë se ka shumë paqartësi rrëth këtij propozimi, kështu që Kuvendi dhe Drejtoria e Financave e cila e procedon tutje dhe e rregullon që ky propozimvendim të mos bie ndesh me ligjin. Ju bëjë thirje të gjithëve që ta votojmë këtë propozim.

Muhamed Selmani tha se ka shumë njerëz që kanë nevojë për ndihmë, për atë arsyе po diskutojmë këtu për të gjetur një metodë ose një modul të saktë se kush janë ata njerëz, ose cilat janë ato kategori që ne do t'i ndihmojmë, dhe të votojmë për të ndihmuar jo vetëm tanë, por edhe në të ardhmen.

Agim Kuleta shprehu mendimin se këtu është një problem që në momentin e vlerësimit të pronave ka ndikuar në rritjen e vlerës në tatim për gjithë qytetarët. Qytetarët kanë qenë të papërgatitur edhe në aspektin psikologjik, andaj qasja jonë duhet të jetë në përputhje proporcionale me këtë problem që është shfaqur. Ideja është ta gjejmë një zgjidhje të mirë, prandaj meqenëse ka ekzistuar vullneti i mirë te të gjithë ne që jemi këtu, para se ta votojmë këtë propozim, mendoj se duhet të ulemi të bisedojmë, ta bëjmë një marrëveshje, ta zgjidhim çështjen në mënyrë racionale duke e parë në aspektin strategjik. Gjithashtu, propozoj që pika e parë e vendimit të ndryshohet dhe të jetë: "Miratohet vendimi për faljen e ndryshimit të shumës së tatimit në pronën e paluajtshme midis viteve tatimore 2022 dhe 2023".

Valbona Ajeti tha se shihet që është një vullnet i mirë i të gjithëve për ta kaluar këtë propozim, andaj mendoj se ky bashkëpunim sadopak do të jetë një ndihmësë e fuqishme për jetën e qytetarëve të Kryeqytetit në këtë periudhë.

Granit Geci pyeti se pse nuk keni kërkuar me u shtyrë aplikimi i tarifave të reja për vitin 2024 ose 2025, duke e ditë që procesi i rivlerësimit të pronave ka qenë i pashmangshëm, pse nuk kërkuan me u shtyrë ky aplikim i tarifave të reja, kjo po më intereson mua. Ne këtu jemi me e bërë një zgjidhje, të vendosim në rrafshin praktik e jo politikë, jo partiak.

Faton Zeka, kërkoi sqarim nga Drejtoria e Financave, duke thënë se, sa ka qenë planifikimi me mbledhje të të hyrave në pronë në vitin 2023 para se të ndodhë rritja, dhe sa ka qenë planifikimi pasi që është bërë rritja, si dhe a dëmtohet Komuna apo nuk dëmtohet me këtë falje deri 100 euro.

Lidhur me vërejtet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtore.

Faqe3nga4

Bahri Gashi tha se jemi për ta votuar këtë propozimvendim, pasi që është edhe afati i fundit, pra të jemi solidarë, t'u ndihmojmë qytetarëve.

Kryesuesja tha se duke pasur parasysh propozimet e paraqitura nga anëtarët e Kuvendit, kërkoj të bëhet një pauzë dhjetëminutëshe, që në ndërkokë të koordinohen grupet parlamentare bashkë me prfaqësuesin e Drejtorisë së Financave, e që më pas të votohet ky propozimvendim.

Gëzim Sveçla tha se pas koordinimit të grupeve parlamentare, është arritur një dakordim, që shuma e falur për tatimin në pronën e paluajtshme të jetë prej 75 euro.

Kryesuesja konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023.

Mbledhja përfundoi në orën 18:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e mbledhjes së Kuvendit
Nora Kelmendi



Faqe4nga4